

Nr. Prot. 2907

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

**MARRËVESHJE KUADËR BASHKËPUNIMI**

E mbajtur sot me datë, 10/10 /2024, bazuar në vullnetin e lirë të palëve.

**Palët:**

**Universiteti Bujqësor i Tiranës**, (në vijim UBT) me adresë: rruga "Pajsi Vodica", Kodër-Kamëz-Tiranë, është institucion i arsimit të lartë në Shqipëri, themeluar në vitin 1951 si "Institut i Lartë Bujqësor" dhe emërtuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 166, datë 28.5.1991 si "Universiteti Bujqësor i Tiranës", i cili funksionon bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e UBT-së, miratuar me Urdhrin nr. 279, datë 28.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i përfaqësuar nga **Rektori Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**.

dhe

**URDHRI PROFESIONAL I MJEKËVE VETERINAR TË SHQIPËRISË** (në vijim UPMVSH), me adresë: rruga "Myslym Keta", 1001, Tiranë, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT/SSN) L61727452J, është ent publik, profesional, i pavarur, i themeluar ne vitin 2016 , i cili funksionon bazuar në ligjin nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar" dhe Statutin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar të Shqipërisë me vendim këshilli (i ndryshuar) me Vendimin nr. 55, datë 18.06.2020, i përfaqësuar nga Presidenti Ervin Resuli.

Të dy institucionet , me synimin e përbashkët dhe vullnetin e tyre të lirë, pajtohen të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional dhe të angazhohen si vijon:

**DUKE DITUR QË:**

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës, këtu e në vazhdim UBT, është institucion publik i arsimit të lartë, si dhe një seli e njohurive të specializuara, të kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive duke luajtur kështu një rol parësor në zhvillimin e edukimit.
2. UBT inkurajon studimin ndërdisiplinor dhe multidisiplinor, shkëmben rezultatet e arritjeve në shkencë me universitete dhe institucione të tjera kërkimore shkencore, duke kontribuar kështu në thesarin e njohurive shqiptare dhe botërore, si dhe duke kontribuar në transferimin e këtyre arritjeve midis studentëve dhe përdoruesve të tjerë.

3. UBT , është i vetmi Institucion i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili nëpërmjet Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, si një nga 5 (pesë) njësitë kryesore në përbërje të tij, edukon dhe formon Mjek Veterinar, nëpërmjet të gjitha kapaciteteve profesionale dhe kërkimore shkencore që disponon në fushën e Veterinarisë.
4. UPMVSH, ka si mision ruajtjen e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik, në kuadër të zbatimit të ligjit të shërbimit veterinar.
5. UPMVSH në kuadër të edukimit në vazhdimësi të mjekëve veterinarë planifikon, organizon dhe monitoron trajnime me mjekët veterinarë dhe persona të tjerë që kryejnë aktivitet profesional të lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe në zbatimin e kërkesave higjieno-veterinare në gjithë zinxhirin ushqimor, teston aftësisë profesionale të tyre, në përputhje me ligjin 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar) si dhe i çertifikon ato.

## NENI 1

### Qëllimi i marrëveshjes

- a) Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave (modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre) të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, palë në marrëveshje.
- b) Të dy palët do të kenë si qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në kuadër të edukimit në vazhdimësi të Mjekëve Veterinarë.

## NENI 2

### Angazhimet e palëve dhe format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet dy Institucioneve do të përfshijë:

- a) UBT do të ndihmojë në ndihmesën me staf akademikë, profesionalë dhe shkencorë, në dispozicion të UPMVSH, për edukimin në vazhdimësi të Mjekut Veterinar;
- b) Disponibilitetin e ambienteve dhe bazën didaktike, të cilat do të vihen në dispozicion sipas nevojës së UPMVSH-së;
- c) Nxitjen, mbështetjen, aplikimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e veterinarisë;
- d) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e) Shkëmbime të literaturës shkencore dhe studimet bashkëkohore;
- f) Institucionalizimin e bashkëpunimit reciprok dhe të ndërsjelltë në sferën e ofrimit të ndihmës për ngritjen e kapaciteteve të mjekëve veterinarë;
- g) Shkëmbimin e eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve;
- h) Zhvillimin e programeve hulumtuese në fushën e veterinarisë;
- i) Organizimin e përbashkët të konferencave, trajnimeve, seminareve dhe bashkëpunimeve të tjera profesionale;
- j) Mbështetje dhe mundësi për studentet e sapodiplomuar nga UBT, duke kontribuar në integrimin e tyre në fushën e mjekësisë veterinarë;
- k) Bashkëpunimin në identifikimin, planifikimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta që do të përmirësojnë praktikën dhe njohuritë në fushën e mjekësisë veterinarë;
- l) Mbështetje në zhvillimin e kursit të Farmacistëve Veterinarë dhe kurseve të tjera të zhvilluar nga UPMVSH me lektorë dhe disponibilitetin e ambienteve të UBT-së.

### NENI 3

#### **Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe e drejta e tërheqjes**

- a) Kjo Marrëveshje lidhet dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar, duke nisur nga data e nënshkrimit të saj.
- b) Palët kanë të drejtën të tërhiqen nga marrëveshja duke bërë kërkesë me shkrim brenda një afati 3 (tre) mujor përpara prishjes së marrëveshjes, duke dhënë arsyen ligjore.  
Në rast tërheqjeje, Palët bien dakord që të përfundojnë aktivitetet në vazhdim në lidhje me Marrëveshjet e Zbatimit të përcaktuara tashmë në datën e tërheqjes, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshjet e Zbatimit individuale.
- c) Në rastin e kërkesës me shkrim për tërheqje, efektet juridike të marrëveshjes shtrihen deri në momentin që priset marrëveshja.
- d) Në qoftë se afati i caktuar për kryerjen e detyrimit të njërit nga palët është thelbësor për interesin e palës tjetër, kjo e fundit kur dëshiron të kërkojë zbatimin pavarësisht prishjes së marrëveshjes, duhet t'i bëjë njoftimin palës tjetër brenda tri ditëve, përveç marrëveshjes së kundërt.

### NENI 4

#### **Kontributet dhe shpenzimet ekonomike**

- a) Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve financiare dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
- b) UPMVSH merr përsipër pagesën e lektorëve sipas tarifave të përcaktuara nga Këshilli kombëtar i UPMVSH-së.
- c) Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.

### NENI 5

#### **Standardet dhe Konfidencialiteti**

- a) Të dyja palët janë të detyruara të përmbushin kushtet e Marrëveshjes me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etikë dhe kompetencë.
- b) Me anë të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, palët zotohen të ruajnë konfidencialitetin.

### NENI 6

#### **Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë. Për ndryshimet dhe plotësimet e saj, si dhe për marrëveshjet e tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve, do të bëhen diskutime paraprake. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta do të bëheni më poshtë:

- Mosmarrëveshjet që mund të lindin, palët do të përpiqen që t'i tejkalojnë me mirëkuptim;
- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtejshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpiqen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit, me bisedime ndërmjet tyre dhe vetëm nëpërmjet komunikimeve zyrtare me shkrim.

#### NENI 7

##### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- a) Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre të mos cenojnë interesat e njëra-tjetrës.
- b) Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje në mënyrë të përsëritur nga njëra prej palëve dokumentuar me shkresë zyrtare, palës tjetër i lind e drejta që të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme, duke njoftuar me shkrim paraprakisht 3 muaj përpara, prishjes së marrëveshjes. Në çdo rast detyrimet që lindin nga marrëveshja në kohën kur ishte në fuqi, duhet të shlyhen.
- c) Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe palët angazhohen të negociojnë për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme.
- d) Për çdo element ligjor që nuk është parashikuar në këtë marrëveshje palët do t'i referohen legjislacionit në fuqi.
- e) Në rast se një mosmarrëveshje nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim palët i drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e saj.

#### NENI 8

##### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale nga dy për secilën palë, të cilat pasi lexohen nga palët, firmosen prej tyre me vullnet të lirë e të plotë dhe vulosen.

**URDHRIN PROFESIONAL TE MJEKEVE  
VETERINARE TE SHQIPERISE**

**PRESIDENT**

**Ervin RESULI**

Nënshkruar në Tiranë, më 10/10 /2024

**UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**

